



**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 57, Datë 02.04.2024

MBI

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR.253, DATË 23.08.2023,
“MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “ERSEKA SOLAR PARK 2” SH.P.K. NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI
FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 20MW (AC)**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 02.04.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 165/5 prot., datë 29.05.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi një ndryshim në Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 253, datë 23.08.2023, “Mbi licencimin e shoqërisë “Erseka Solar Park 2” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 20MW(AC).

Konstatohet se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 253, datë 23.08.2023 ka vendosur të licencojë shoqërinë “Erseka Solar Park 2” sh.p.k, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 20 MW (AC), për një afat 30 vjeçar duke i lënë kusht shoqërisë të informojë ERE-n çdo 3 (tre) muaj në lidhje me fillimin e punimeve të ndërtimit të centralit fotovoltaik, deri më datën 21.02.2024.
- ERE me shkresën nr.165 prot., datë 16.01.2024, i kërkoi shoqërisë informacion në lidhje me fillimin e punimeve të ndërtimit të centralit fotovoltaik, pasi shoqëria nuk kishte informuar sipas afatit të përcaktuar. Shoqëria me shkresën e protokolluar në ERE nr.165/2 prot., datë 19.01.2024 depozitoi vendimin e KKT-së, gjithashtu ka informuar se është në pritje të zbardhjes së lejes dhe po ashtu është në proces të përgatitjes të dokumentacionit për të aplikuar për një VNM të re.
- Në vijim ERE me shkresën nr. 165/3 prot., datë 29.02.2024 i kërkoi shoqërisë të depozitojë VNM-në e re pasi në shkresën e fundit shoqëria shprehet se është në proces të përgatitjes të dokumentacionit për të aplikuar. Në përgjigje shoqëria me shkresën nr. 165/4 prot., datë

06.03.2024 ka depozituar aplikimin nr.AN040320240002 dhe mandatin bankar për pagesën e tarifës së aplikimit për VNM në datë 26.02.2024.

- Gjatë marrjes së vendimit nr. 235/2023, shoqëria “Erseka Splar Park 2” sh.p.k. dispononte VNM të vlefshme, si e tillë i është lënë kushti të informojë çdo 3(tre) muaj në lidhje me fillimin e punimeve për ndërtimin e centralit fotovoltaik brenda afatit të vlefshmërisë së VNM-së, pra brenda datës 21.02.2024.
- Aktualisht duke marrë në konsideratë që ka përfunduar VNM dhe subjekti ka bërë me dije se nuk ka nisur ende punimet por ka aplikuar për një VNM të re, por ende nuk e ka depozituar atë, si e tillë vlerësohet të ndryshohet pika 2 e vendimit të Bordit nr.253/2023, duke i vendosur kushtin shoqërisë përpara se të fillojë veprimtarinë e operimit/ushtrimit të energjisë elektrike,shoqëria “Erseka Solar Park 2” sh.p.k. të depozitojë në ERE, VNM-në e re.
- Në nenin 113 të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” është parashikuar mundësia e ndryshimit të një akti, me nismën e vet organit, që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Pika 2 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 253/2023, ndryshon dhe bëhet:
 2. *Përpara fillimit të operimit/ushtrimit të veprimtarisë së energjisë elektrike ,shoqëria “Erseka Solar Park 2” sh.p.k. të depozitojë në ERE VNM e re.*
2. Pika 3 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 253/2023, ndryshon dhe bëhet:
 3. *Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në varësi të depozitimit të VNM-së së re.*
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË

Erjola SADUSHI